



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKTVENDIM

Nr 7172, Datë 30 . 05 . 2025

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIT PËR 4 MUJORINE PARË TË VITIT 2025

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës, Këshillit të Bashkisë Lezhë;

Për të vendosur:

1. Miratimin e Buxhetit Faktit për 4 mujorin e parë të vitit 2025, sipas relacionit dhe pasqyrave përkatëse, bashkëlidhur këtij projektvendi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 71721 Prot.

Lezhë, më 30. 05 . 2025

RELACION

**LIDHUR ME PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
BUXHETIT FAKTIK PËR 4 MUJORIN E PARË TË VITIT 2025**

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; ju paraqesim projektvendimin për realizimin e Buxhetit Faktik për 4 mujorin e parë të vitit 2025 për shqyrtim dhe miratim nga ana Juaj.

Lidhur me realizimin e Buxhetit Faktik për 4 mujorin e parë të vitit 2025, relatoj si më poshtë:

- Të ardhurat nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore janë realizuar 25.7% ose 374,297.1 mijë lekë më pak se plani, respektivisht sipas burimeve janë: Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar 19.1% ose 209,087.7 mijë lekë më pak se plani; Të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar 104.5% ose 1,082.9 mijë lekë më shumë se plani; Të ardhurat nga tarifat vendore janë realizuar 57% ose 38,145.1 mijë lekë më pak se plani; Të ardhurat e tjera janë realizuar 3.6 % ose 128,147.2 mijë lekë më pak se plani. Në raport me të njëjtën periudhë të vitit kaluar të ardhurat janë realizuar 62.9% ose 76,363.1 mijë lekë më pak.
 - Shpenzimet janë realizuar 37.5% ose 629,123.7 mijë lekë më pak se plani, respektivisht, Shpenzimet korrente janë realizuar 58.7% ose 256,696.25 mijë lekë më pak se plani dhe shpenzimet kapitale (investimet) janë realizuar 3.1% ose 372,427.5 mijë lekë më pak se plani. Në mënyrë të detajuar të dhënat e zbatimit të Buxhetit Faktik për 4 mujorin e parë 2025, jepen në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e parë 2025, bashkëlidhur projektvendimit.
- Me respekt,

KRYETARI
Pjerin Ndreu

